



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SIGURIMIT TE
INFORMACIONIT TE KLASIFIKUAR

Bul. Dëshmorët e Kombit, Tiranë

Tel/Fax : 355 4 229360

Nr. 69 Prot.

Kopje Nr.2
Tiranë, 28.5.2010

L ë n d a : Njoftim për nxjerrjen në ankand të tre automjeteve në DSIK.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Këshilli i Ministrave, me adresë pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë, ka filluar procedurat për nxjerrjen në ankand të tre automjeteve, në pronësi të saj, në bazë të vendimit nr. 1242, datë 16.12.2009 , të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e funksionimit të Komisionit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.

Në zbatim të pikës II, të VKM, nr. 1242, datë 16.12.2010, “Metoda e përdorur për nxjerrjen e vlerës fillestare” dhe shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr. 1401/1Prot, datë 25.03.2010, “Në lidhje me vlerësimin e automjeteve të transportit që do ti nënshtrohen procedurave të ankandit”, vlera fillestare e ankandit të automjeteve është:

Nr	Tipi i Automjetit	Marka e Automjetit	Modeli	Viti i prodhimit	Të dhëna Teknike	Vlera fillestare e ankandit
1	Veturë	Opel	Omega	1999	Ngjyra: gri, Vende: 4+1, benzinë, vëllimi i motorit: 1989 cm ³ , kambio manuale	125.000 lekë
2	Autoveturë	Wolksvagen	Golf	1993	Ngjyra: zezë, Vende: 4+1, benzinë, vëllimi i motorit: 1598 cm ³ , kambio manuale	75.000 lekë
3	Fuoristradë	Nissan	Patrol	1985	Ngjyra: blu, Vende: 6+1, naftë, vëllimi i motorit: 2498 cm ³ , kambio manuale	125.000 lekë

Çdo person i interesuar mund të paraqesë pranë këtij institucioni brenda datës 28.6.2010:

- kërkesën për pjesëmarrjen në procedurën e ankandit
- dhe ofertën me shkrim.

Këto oferta mund të paraqiten pranë institucionit tonë:

- a. Dorazi.
- b. Njëpërmjet postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf.
- c. Rrugë elektronike.

Vendi i zhvillimit te ankandit: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë, Kati i dytë.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 28 qershor 2010, ora 10:00.

Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen:

Në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, kundrejt një pagese prej 1000 (një mijë) lekë,

ose

Në faqen zyrtare të internetit të DSIK-së: www.nsaalbania.gov.al

D R E J T O R I

Shyqyri DEKAVELLI